

Të drejtat e fëmijëve

# ÇFARË ËSHTË VLERËSIMI I INTERESIT MË TË LARTË?

**Për fëmijët (nën 18 vjeç) që kanë mbërritur vetëm, caktohet një person i quajtur kujdestar për mbështetje.**

→ Vlerësimi i interesit më të lartë është një takim ku një nëpunës i trajnuar ju dëgjon me vëmendje dhe ju drejton pyetje për të kuptuar nevojat tuaja për mbrojtje dhe kujdes.

→ Informacionet që ju jepni do t'i ndihmojnë ata në marrjen e vendimeve të rëndësishme, duke pasur parasysh sigurinë, mirëqenien dhe të ardhmen tuaj.

## KËTO VENDIME MUND TË PËRFSHIJNË

- Kujdesin mjekësor që është i domosdoshëm për ju.
- Shkollën ose punën që ju përshtatet.
- Vendin ku do të jetoni.
- Personin që do të kujdeset për ju.

## KUJDESTARI JUAJ JU NDIHMON

- Për të biseduar me autoritetet.
- Për të mësuar sesi të aksesoni shërbime mbështetëse.
- Për të lënë takime.
- Për t'u informuar rreth kulturës dhe jetës në këtë vend.

## GJATË VLERËSIMIT, INFORMONI NËPUNËSIN NË RAST SE

- Ndiheni paqejf, të mërzitur ose të shqetësuar apo në rast se dikush ju ka lënduar.
- Keni familjarë në Evropë.
- Jeni me familjen tuaj, por ata nuk munden ose nuk duan t'ju mbështesin.

Tregojini nëpunësit se çfarë ju motivon dhe çfarë ju jep shpresë.



I gjithë informacioni i ndarë gjatë vlerësimit të interesit më të lartë mbetet privat.

## MOS HARRONI

- Kërkoni një përkthyes nëse nuk e flisni gjuhën.
- Mund të zgjidhni një nëpunës mashkull ose femër për t'ju ndihmuar gjatë vlerësimit.
- Të gjithë nëpunësit duhet t'ju trajtojnë me respekt.
- Bashkëpunoni me nëpunësit kur mundeni.



© Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin, 2025

euaa
EUROPEAN UNION AGENCY FOR ASYLUM